



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës së Kuvendit

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 22. 12. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit**

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni-Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Radmila Vujovic.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni-Kaloshi - kryetar i Komisionit.

**R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Amendamenti i Projektregullores së Kuvendit,**
- 3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian,**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua njëzëri.*

**2. Amendamenti i Projektregullores së Kuvendit**

**Hydajet Hyseni** - Lidhur me amendamentimin e Projektregullores tha se kemi menduar ta organizojmë një punëtori së bashku me NDI-në dhe OSBE-në, mirëpo për shkak të festave të fundvitit mbetet që të organizohet në janar, kur edhe do të procedohet për miratim. Projektregullorja është e nevojshme të harmonizohet me sugjerimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, për të cilat Komisioni për Integrim do t'i paraqesë propozimamendamentet. Po ashtu në Projektregullore është e nevojshme të saktësohen pjesëmarrja e deputetëve në mbledhjet e Kuvendit, mungesat, shtesat, të cilat tani për tani nuk janë të saktësuara në Rregulloren ekzistuese. Propozoi të fillohet me amendamentim ose në mbledhjen e ardhshme të sillen amendamentet dhe të fillojë shqyrtimi i tyre.

**Besa Gaxherri** - Sa i përket amendamentimit të Projektregullores tha kam menduar se është çështje e përmbyllur, por nëse është e nevojshme do ta mbështes mendimin e anëtarëve të Komisionit.

**Ahmet Isufi** - Kërkoi nga kryetari i Komisionit të bisedojë me Komisionin për Integritet lidhur me harmonizimin me sugjerimet e Raportit të Komisionit Evropian dhe me GP-PDK-në për ta informuar Komisionin, pse është tërhequr nga seanca miratimi i Projektregullores së Kuvendit dhe t'i paraqesin vërejtjet e tyre që t'i ketë Komisioni.

**Hydajet Hyseni** - Njoftoi se shtyrja e miratimit të Projektregullores është bërë me kërkesë të një GP, për të cilin ka vendosur Kuvendi, me arsyetim se në fund të stinorit nuk mund të sigurohet kuorumi i nevojshëm për ta miratuar Rregulloren me 2/3 e deputetëve, si dhe për çështjen e pasqaruar lidhur me komisionet e formuara.

**Suzan Novobrdaliu** - Shtroi pyetjen se a do të mund të procedohet Projektregullorja në Kuvend gjatë muajit janar, duke i pasur parasysh festat dhe kushtëzimin e punës nga Komisioni për Integritet Evropiane.

**Hydajet Hyseni** - Njoftoi se Komisioni për Integritet Evropiane do t'i parashtrojë 3 ose 4 amendamente që janë të draftuara dhe eventualisht mund të parashtrohen 2 ose 3 amendamente të tjera, nëse janë të arsyeshme.

**Ahmet Isufi** - Propozoi që në tekstin e Projektregullores të inkorporohen çështjet të cilat lidhen me Raportin e Progresit që pasi t'i kemi në formë të shkruar dhe pasi ta kemi mendimin, qoftë të kryetarit të Kuvendit, të Kryesisë ose të GP-re, të fillohet të punohet.

**Hydajet Hyseni** - Propozoi që Komisioni pasi t'i marrë rekomandimin me amendamente nga Komisioni për Integritet Evropiane dhe eventualisht ndonjë propozim tjetër nga deputetët, GP-re, ose nga Komisioni për Buxhet, lidhur me praninë dhe kompensimet e deputetëve, atëherë do të mund të organizohet një drekë pune, që të harmonizohen propozimet e palëve dhe të përafrohet puna për janar.

*Komisioni pas diskutimeve nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

*Në mbledhjen e radhës së Komisionit të sillen propozimet për amendamentimin e Projektregullores në formë të shkruar .*

**Të ndryshme**

**Hydajet Hyseni** - Kërkoi që për punën e Komisionit gjatë këtij viti të përgatitet raporti vjetor.

*Komisioni nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

*Të angazhohet stafi për përgatitjen e raportit vjetor të punës të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të punës të Kuvendit.*

*Pas diskutimeve të deputetëve: Hydajet Hyseni, Ahmet Isufi dhe përfaqësuesve të NDI-së dhe OSBE-së, për mënyrën e procedimit të Projektregullores së punës të Kuvendit, Komisioni nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

*Komisioni vendosi që gjatë muajit janar ta mbajë një takim të përbashkët me Kryesinë e Kuvendit, me kryetarët e GP-re, me përfaqësues të Komisionit për Integritet Evropian për harmonizimin e qëndrimeve dhe ta procedojë Projektregulloren për miratim në Kuvend.*

*Komisioni pas diskutimit për nevojën e përmirësimit të kushteve për punën e anëtarëve të Komisionit dhe të stafit të tij mbështetës, nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

Të kërkohet, që në kuadër të buxhetit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit, anëtarët e Komisionit dhe stafi të pajisen me fjalorë, si dhe të sigurohet mbushje telefoni për stafin mbështetës të Komisionit për nevoja pune të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E hartoi:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Hydajet Hyseni -Kaloshi